

**"IMLS" SH.P.K.**

**Regjistruar në QKB: dt. 21.03.2016.**

**NUIS: L61521002R.**

**Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, Shqipëri.**

**EKSTRAKT I VENDIMIT**  
**TË ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**  
**"IMLS" SH.P.K.**  
**Nr. 18, Datë 18.04.2024.**

Sot, më datë 18.04.2024, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "IMLS" sh.p.k., me adresë në: Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 1, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më datë 21.03.2016, me NUIS L61521002R, e përbërë nga zotëruesit e 100% të kuotave të kapitalit:

1. **Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Investment Joti – Infosoft Group",** e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, më datë 25.02.2009, me NUIS K91425022E, me Administrator Znj. Blerta Elezaj, e cila zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.
2. **Z. Plarent Kristo,** i cili zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.
3. **Z. Roland Joti,** i cili zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.

Duke qenë se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve plotëson kuorumin e caktuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me çështjen e rendit të ditës.

Asambleja ka për rend dite:

- Diskutim në lidhje me destinimin e fitimit të vitit financiar 2023 të shoqërisë "IMLS" sh.p.k.

Në përputhje me nenin 9.8 të Statutit të shoqërisë "IMLS" sh.p.k., i ndryshuar më dt. 06.12.2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me unanimitet,

**VENDOSI:**

1. Referuar pasqyrave financiare vjetore për vitin financiar 2023, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 17, dt. 18.04.2024, rezulton fitimi në vlerën 20,081,359 (njëzet million e tetëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë.
2. Pjesa e fitimit në vlerën 81,359 (tetëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë do të shpërndahet tek Ortakët e Shoqërisë, në përputhje me përqindjen respektive të pjesëmarrjes së secilit Ortak në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, përkatësisht:
  - "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k. – 27,119.666 (njëzet e shtatë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë;
  - Z. Plarent Kristo – 27,119.666 (njëzet e shtatë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë;
  - Z. Roland Joti - 27,119.666 (njëzet e shtatë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

Për sa më sipër, plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 77 dhe 78 i Ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe nga Statuti i Shoqërisë. Kjo konfirmohet nga Certifikata e Aftësisë Pagueuse, e lëshuar nga Administratori i Shoqërisë, nën përgjegjësinë e tij të plotë.

  
Faqe 1 nga 2

Në përputhje me Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 58 "Të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim", neni 29 "Përjashtimi nga pjesëmarrja" dhe neni 59 "Norma e mbajtjes së tatimit në burim", Ortakut "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k. nuk do t'i llogaritet tatimi në burim mbi dividendin, kurse dy Ortakëve të tjerë, Z. Plarent Kristo dhe Z. Roland Joti, do t'u llogaritet tatimi mbi dividendin në masën 8%.

3. Pjesa e fitimit në vlerën 20,000,000 (njëzet milion) lekë do të destinohet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "IMLS" sh.p.k., në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi, sipas përqindjes respektive të pjesëmarrjes së secilit Ortak në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, përkatësisht:

- "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k. – 6,666,666.666 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë;
- Z. Plarent Kristo – 6,666,666.666 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë;
- Z. Roland Joti - 6,666,666.666 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Në përfundim të procesit të zmadhimit të kapitalit, kapitali i regjistruar i shoqërisë "IMLS" sh.p.k. do të bëhet 80,000,000 (tetëdhjetë milion) lekë, i ndarë në 3 (tre) kuota me vlerë nominale si më poshtë:

Nr.	Ortakët	Vlera e kapitalit para zmadhimit		Vlera e kapitalit pas zmadhimit	
		Vlera nominale (lekë)	Në %	Vlera nominale (lekë)	Në %
1.	"Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k.	20,000,000	33.333%	26,666,666.666	33.333%
2.	Z. Plarent Kristo	20,000,000	33.333%	26,666,666.666	33.333%
3.	Z. Roland Joti	20,000,000	33.333%	26,666,666.666	33.333%
	<b>Total</b>	<b>60,000,000</b>	<b>100%</b>	<b>80,000,000</b>	<b>100%</b>

5. Depozitimim e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore.

6. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, departamenti ligjor dhe departamenti i financës për ekzekutimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### ORTAKËT

"Investment Joti-Infosoft Group" sh.p.k.

Blerita ELEZAJ



Plarent KRISTO



Roland JOTI